



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura VIII
Sesioni pranveror

Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Inovacion, Kulturë, Rini dhe Sport

Mbledhja nr.81
Prishtinë, më 28.05.2024, në orën 10:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225.

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Ardian Gola, kryetar, Albena Reshitaj, Eliza Hoxha, Arijeta Rexhepi, Jahja Kokaj dhe Arjeta Fejza.

Munguan: Enis Kervan, Ardian Kastrati, Adriana Matoshi dhe Vlora Dumoshi.

Stafi mbështetës i Komisionit: Lule Ymeri dhe Shaip Goxhuli.

Mbledhjen e kryesoi: Ardian Gola, kryetar i Komisionit.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur me 23.05.2024;
3. Shqyrtimi i raportit me rekomandime për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit nr.05/L-90 për Sponzorizime në fushën e Kulturës, Rinisë dhe Sportit i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-116.
4. Të ndryshme

Kryetari, konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës së Komisionit dhe e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Ardian Gola, propozoi që rendi i ditës të plotësohet me një pikë për shpalljen e konkursit për anëtarë të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturor.

Me këtë propozim u pajtuan anëtarët e Komisionit dhe u miratua rendi i ditës.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 23.5.2024

Procesverbali i mbledhjes së mbajtur më 23.5.2024, u miratua pa vërejtje.

Ardian Gola, tha se Grupi punues kryesuar nga deputetja Eliza Hoxha ka përgatitur raportin me rekomandime për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit nr 05/L-90 për sponsorizimin e fushave të kulturës rinisë dhe sportit i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin numër 06/L-116, si Komision duhet shiquar rekomandimet e dala dhe të procedohet raporti për miratim në Kuvend.

Eliza Hoxha, tha se raporti përmbledh aktivitetin e grupit punues me pjesën e federatave, të institucioneve tjera dhe në takimin në Ministri. Sa i përket sponsorizimeve fusha e sportit është më e qartë ngase federatat janë të licensuara ndërsa tek artistët kjo çështje është problematike dhe e paqartë. Ministria vendos se kush mundet me marrë sponsorizim, kjo për arsye se nuk është e rregulluar data baza e artistëve e nuk ka asnjë aspekt vlerësues se kush është artist dhe çfarë vlere përfaqëson, gjithashtu nuk është i organizuar komisioni, pastaj çështja e vonesave ka pasur raste që janë vonuar 3 deri në 4 muaj, edhe në kuptimin e shqyrtimit të raporteve finale kur janë dorëzuar raportet e përfundimit të projektit por edhe në anën tjetër në kërkesën për të marrë vërtetimin që je artist për me pasë qasje në sponsorizime. Tek pjesa e grupacioneve të interesit në këtë rast pjesa e kulturës dhe rinia, pastaj tek sponsorizimi në trashëgimi që dihet se është fushë shumë e ndjeshme investimi publik në objekte të trashëgimisë kulturore dhe cila është vija e përgjegjësisë që mundet me iu nda spektrit civil. Aspekti bazik i ligjit parasheh qasje e barabartë në fonde e resurse e që me Ligji nuk është përfshi barabarsisht dhe kjo ka qenë arsye për monitorim të këtij ligji.

Arjeta Rexhepi, tha se së bashku si një grup punues që kemi mbikëqyrë këtë ligj të rëndësishëm dhe gjatë punës sonë kemi dëgjuar halle të ndryshme të grupeve të interesit. Në raportin tek faqja 3 tek paragrafi ku thotë “përndryshe ATK vazhdon ta kundërshtoj zbatimin e këtij ligji” e dijmë se një kohë ka pasur probleme me ATK-në por kemi sqarimin tek një pjesë ku nga vitit 2019 është rregullu me Ligjin për të ardhura të korporatave dhe këtu bie në kundërshtim vetë paragrafi ku thuhet për kundër efekteve pozitive që i ka dhënë ligji në teren, si mundet që ligji që nuk respektohet me dhanë efekte pozitive në teren. Në vazhdim përmendi disa pjesë të raportit të cilat duhet përmirësuar tek se faqe 4 ku thuhet se pasluftës edhe pse klubet dhe federatat u kthyen në objektet që i kanë shfrytëzuar në kohën e paraluftës institucionet e Kosovës nuk kanë hartuar legjislacion që mundëson financim stabil dhe zhvillim të qëndrueshëm, edhe tek faqja 8 ku thuhet për proporcionin 90 me 10 në favor të sportit në anën tjetër artistët e pavarur dhe individë të tjerë që duan të prodhojnë vepra arti nuk janë të regjistruar në asnjë data bazë regjistër shoqata sindikata çfarë do ombrelle organizative. Tek paragrafi i fundit ligji është konsideruar si burim vital i sponsorizimit të sportit kulturës dhe rinisë sportit, këtu është si e pakuptimtë çfarë do ndryshimi që do të konfliktonte zbatimin e ligjit në teren do të ishte pengesë e madhe për zhvillimin e sportit kulturës. Më pas tek faqja 11 thotë shqetësim tjetër është kapaciteti përpunues i vërtetimeve për sponsorizime, tek rregullorja kemi gjetë edhe gabime të tjera, duhet me obligu MKRS-në edhe

me rishiku edhe rregulloren si dhe ndryshimi i përbërjes së komisionit të specifikohet në rekomandim.

Eliza Hoxha, tha se fakti që sporti ka qenë më i strukturuar edhe donatorët i kanë besuar më shumë, si dhe ka pasur përqindje më të madhe, sidomos në sport ku 90 përqind të sponsorizimeve i ka marrë sporti, problemi është që vetë federatat kanë pasur probleme ose kompani të cilat kanë dhënë në zbatueshmërinë e atij lirim prej tatimit dhe ATK ka pasur kundërshti më së shumti. Tek ligji për art dhe kulturë këtë duhet me e verifikuar dhe ka mundësi ligji edhe institucioneve publike me marrë sponsorizime.

Arjeta Fejza, tha se është mirë të definohet më mirë puna e këtij Komisioni dhe duhet me kërkua edhe rregulloren. Tek sponsorizimet duhet me u monitoru konkretisht çështja e interesit publik tani kemi inspektoratin e sportit, në kulturë inspektoratin e kulturës, në rini e kemi agjensinë, dhe me monitoru se qysh po shkon si proces sepse ka pasur shumë aneksa që çdo organizim që merret me kulturë rini dhe sport ka të drejtë të aplikoj për sponsorizim. Duhet të definohet se qysh ka me u adresu interesi publik, dhe për punën e përqindjes nuk mendoj që barazimi mes sportit kulturës rinisë e dëmton sportin. Është e rëndësishme për zbatimin më të mirë të këtij ligji të rritet monitorimi dhe të përcaktohen akterët të cilët e monitorojnë këtë ligj dhe të bëhet saktë përcaktimi i procedurave administrative për procedimin sponsorizimin duke përfshirë MKRS ATK dhe institucione të tjera relevante.

Jahja Kokaj, tha se kur është fjala tek diskriminimi i kulturës rinisë dhe edukimi duhet të jetë natyrisht, sidomos aspekti i hulumtimit është shumë relevant sepse investimi në hulumtim konsiderohet si veprimtari riprodhuese jo si shpenzim emocional dmth patjetër duhet të jetë një vlerë më e madhe, sa i përket pikës 5 të raportit e shoh një fjali shumë të fuqishme që nëse një vepër paraqet vlerë kombëtare ose publike sponsorizimi i saj duhet të bëhet sipas ligjit, nuk shoh që ka ndonjë hierarki të ndonjë fjalie tjetër që e tejkalon këtë. Në pikën e 8 është e domosdoshme të mbyllet të gjitha zbrazëtit dhe të eliminohen dy kumtimësitë në zbatimin e këtij ligji për procedura ose veprimet.

Ardian Gola tha se raporti me rekomandime për mbikqyrjen e zbatimit të ligjit numër 05/L- 90 për sponsorizimin e fushave të kulturës rinisë dhe sportit i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin numër 06/L- 116. të plotësohet me vërejtjet që u dhanë nga anëtarët e Komisionit.

Komisioni me gjashtë (6) vota për asnjë kundër miratoi raportin me rekomandime për mbikqyrjen e zbatimit të ligjit numër 05L 90 për sponsorizimin e fushave të kulturës rinisë dhe sportit i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin numër 06L 116 dhe i njëjti procedohet në Seancë plenare.

4. Diskutim lidhur me shpalljen e konkursit për anëtarë të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturorë

Ardian Gola, tha se meqë KKTK i skadon mandati në muajin korrik të këtij viti me qëllim të përmbushjes së obligimeve ligjore), Komisioni duhet të marrë vendim shpalljen e konkursit për zgjedhjen e anëtarëve në Këshillin e Kosovës për Trashëgimi Kulturore (KKTK).

Komisioni, me gjashtë (6) vota për, asnjë kundër mori këtë :

V E N D I M

Të shpallet konkursi për zgjedhjen e 7 (shtatë) anëtarëve në Këshillin e Kosovës për Trashëgimi Kulturore (KKTK), në pajtim me nenin 4.8 të Ligjit nr.02/L-88 për Trashëgimi Kulturore.

5. Të ndryshme

Për këtë pikë nuk pati diskutime.

Mbledhja përfundoi në orën 11:30

E përgatiti:

Stafi mbështetës i Komisionit.

Ardian Gola

Kryetar i Komisionit